## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT (DPS)

### 1. REALIZIMI I PLANIT VJETOR 2021

| NR | ÇESHTJET | REALIZIMI | MOS REALIZIMI | ARSYEJA |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH)**<br><br>Gjatë vitit 2021 janë adoptuar si Standarde Shqiptare (SSH); 2225 Standarde Evropiane dhe Ndërkombëtare, duke përfshirë amendamentet dhe dokumentet e standardizimit; nga të cilat:<br>- **844 CEN;**<br>- **454 CENELEC;**<br>- **400 ETSI;**<br>- **336 ISO;**<br>- **191 IEC.**<br><br>Në total (duke llogaritur dhe shfuqizimet) janë adoptuar 29,151 standarde Evropiane (CEN, CENELEC dhe ETSI) si SSH, konkretisht 4,435 standarde ETSI, 7,714 CENELEC dhe 17,002 CEN; 6,213 janë standarde Ndërkombëtare (ISO dhe IEC).<br><br>**Të dhëna të rëndësishme:**<br><br>● Gjithsej, gjatë këtij viti janë adoptuar rreth **2225** standarde dhe dokumente standardizimi si Standarde Shqiptare (SSH) dhe Dokumente Standardizimi Shqiptare (DS); nga ku **1045** në fushën e elektroteknikës dhe telekomunikacionit - Sektori CENELEC/IEC/ETSI dhe **1180** standarde nga të gjitha fushat e ekonomisë – Sektori CEN/ISO.<br><br>● Pjesa më e madhe janë standarde me origjinë evropiane, rreth **1698** standarde (CEN, CLC dhe ETSI) dhe **527** standarde ndërkombëtare (ISO dhe IEC); | 100% | - | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Fushat ku Komitetet Teknike kanë pasur numër më të madh adoptimesh janë si më poshtë:**<br>➢ Analizat e produkteve ushqimore;<br>➢ Pajisjet mjekësore;<br>➢ Tekstile dhe prodhime tekstili;<br>➢ Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës;<br>➢ Zbatime në hekurudhë;<br>➢ Siguria teknike dhe mjedisi;<br>➢ Sistemet e telekomunikacionit analoge dhe dixhitale;<br>➢ Materiale elektrike dhe elektronike.<br><br>● Janë shfuqizuar rreth **628** standarde (**492** me origjinë evropiane dhe **136** me origjinë ndërkombëtare) sipas fushave të caktuara dhe Komiteteve Teknike përkatëse, duke ndjekur "ciklin e jetës" së standardit.<br><br>● Janë realizuar **2** mbledhje të Bordit Teknik të DPS**,** i cili ka miratuar Programet 6-mujore të punës për adoptimin dhe ndryshimet në Përbërjen e Komiteteve Teknike të DPS, që kanë funksionuar gjatë vitit 2021.<br><br>● Janë adoptuar **100%** standardet e harmonizuara nën Direktivat përkatëse si dhe është realizuar përditësimi dhe rifreskimi i listave të tyre nga Sekretarët e KT-ve.<br><br>● Janë adoptuar rreth **85** standarde me procedurë të përshpejtuar sipas kërkesave të klientëve, palëve të interesuara (biznese, institucione, laboratore, persona fizikë) kryesisht në fushat si më poshtë:<br>- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës;<br>- Tekstile dhe prodhime tekstili;<br>- Vajra dhe yndyrna ushqimore - Fara vajore;<br>- Siguria teknike dhe mjedisi;<br>- Teknologjia e komunikimit dhe informacionit.<br><br>● Në kushtet e pandemisë shkaktuar nga COVID-19, si dhe masave të ndërmarra për minimizimin e përhapjes së saj, komunikimi me DPS/KT është realizuar me të gjitha mjetet e ICT në dispozicion, nga Sekretarët e | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | KT-ve. Komunikimi është realizuar me rreth **54** Komitete Teknike (KT) (rreth **121** Vendime adoptimi dhe rreth **67** Vendime shfuqizimi), sipas fushave të caktuara për adoptimin e standardeve dhe dokumenteve të standardizimit evropiane dhe ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH), në të gjitha fushat e ekonomisë, duke përfshirë edhe fushën e elektroteknikës dhe telekomunikacionit. | | | |
| 2 | **Integrimi - Procesi *screening***<br><br>- U miratua VKM 673/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 382/2018 "Për miratimin e Rregullores për veprimtarinë e standardizimit"; - transpozim i plotë me Rreg./EC 1025/2012;<br>- Përgatitja e kontributit për 3 Kapituj të Acquis (Kap.1, 20 dhe 28),<br>- Evidentimi i situatës dhe progresi përkatës në fushën e standardizimit | 100% | - | |
| 4 | **Promovimi dhe publikimet**<br>Janë përgatitur gjithsej:<br>- **Rreth 100 ekstrakte standardesh të fushave të ndryshme,** kryesisht fushat e: 'Mjekësisë', 'Naftës', 'Ndërtimit', 'Gazit', Pajisje mjekësore', Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës', Pajisje shtëpiake', Pajisje dentare', 'Pajisje elektroshtëpiake' etj.<br>- **70 artikuj/njoftime të përkthyer**, të Organizmave Evropianë dhe Ndërkombëtar të Standardizimit, ISO/CEN/CENELEC.<br>- **Buletini Nr. 85** për periudhën Tetor – Dhjetor 2020 (publikuar janar 2021);<br>- **Shtojca I Nr. 85** për periudhën Tetor – Dhjetor 2020 (publikuar janar 2021;<br>- **Buletini Nr. 86** për periudhën Janar – Mars 2021;<br>- **Buletini Nr. 87** për periudhën Prill – Qershor 2021 Korrik – Shtator 2021; | 100% | - | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | - **Buletini Nr. 88** për periudhën Korrik – Shtator 2021<br>- **Programin 6 mujor** të punës së standardeve.<br>- **Notifikimet lidhur me reduktimin e barrierave teknike në tregti;**<br>- **OBT/CEFTA.**<br>- **Përditësimi i rubrikës dialog me palët**.<br>- **150 Rishtypje standardesh**.<br><br>**Takime/Prezantime:**<br><br>- Jamë kontaktuar kompani, të cilat kanë blerë standard gjatë këtij viti dhe është duskutuar në lidhje me standardet me interes për to. | 100% | | |
| 5 | **Realizimet në kuadër të Projektit të IPA III**<br>- U realizuan trajnimet për sa i përket dokumentacionit për aplikimin në CEN&CLC;<br>- U rishikuan rreg.e brendshme dhe gjithë procedurat e punës së DPS;<br>- Përfundoi draft strategjia për st., e cila pret miratimin nga BD dhe do shkojë në MFE për më tej;<br>- U kompletua gjithë dok.për dosierin dhe u dërgua aplikimi zyrtar në CEN&CLC;<br>- U bënë ndryshimet në databazën e DPS si dhe u bënë shumë trajnime lidhur me mbarëvajtjen e saj;<br>- Faqja e DPS ka ndryshuar dhe përmirësuar, si rezultat i ndryshimeve në databazë; | 100% | | |
| 6 | **Shitja e standardeve**<br><br>**Janë shitur gjithsej 1297, ku 996 janë me origjinë evropiane.**<br><br>*Standardet më të shitura për vitin 2021 janë në fushat:*<br>- Sigurimi i cilësisë dhe përgjegjësia sociale | 100% | - | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | - Eurokodet strukturore<br>- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës (SSH ISO 11923:1997) | | | |
| 6 | **Shërbimet**<br>- U dorëzua në afat bilanci i DPS për vitin 2020<br>- Janë kryer të gjitha pagesat për të tretë (ujë, energji, postë, telefon, security, udhëtim e dieta);<br>- Paga, sig.shoqërore, shëndetsore e tatime, pagesat e kuotave të anëtarsimit në org.europiane e ndërkombëtare të standardizimit;<br>- U hartua kontrata dhe u krijuan kushtet e punës për një student të ekselencës;<br>- Janë plotësuar dhe përditësuar dosjet e personelit në sistemin HRMIS;<br>- Është hartuar Regjistri i Parashikimeve për Prokurimet Publike (RPPP)<br>Eshtë studiuar tregu dhe pergatitur Aneksi 3 për Pajisjet TIK për nevoja të DPS. Pritet miratimi nga AKSHI. | 100% | - | |

**2. MOS REALIZIMET**

| NR | DEGA RAJONALE | ARSYEJA E MOSREALIZIMIT |
|---|---|---|
| 1 | Nuk ka | |

**3. ANKESAT NGA BASHKEQEVERISJA**

| NR | ANKESA | ZGJIDHJA | MOSZGJIDHJA | ARSYEJA |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nuk ka | | | |